

**GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ, DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM - DIVIZIONI PENAL**, si gjykatë e shkallës së parë penale, gjyqtari Adem Shabani, me zyrtarin ligjor Blend Rexhepi, procesmbajtës, në lëndën penale kundër të pandehurit [REDAKTUE] nga fshati [REDAKTUE], Komuna Ferizaj, e duke vendosur sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore ne Ferizaj - Departamenti i Përgjithshëm PP/I/nr.2476-4/2017 të datës 14.12.2017 përvepër penale , rrezikimi i trafikut publik nga neni 378 par 9 e lidhur me par 1 dhe 6 të KPRK-së, pas përfundimit të shqyrtimit filletar , publik dhe me gojë te mbajtur në praninë të Prokurori shtetit Bahri Hyseni, e të pandehurit [REDAKTUE] dhe përfaqësuesin e tij me autorizim Av. [REDAKTUE] me datën 15.03.2018 , të njëjtën ditë mori dhe publikisht shpalli këtë:

#### A K T G J Y K I M

I pandehuri [REDAKTUE] nga fshati [REDAKTUE] Komuna Ferizaj, i lindur me datën [REDAKTUE], në [REDAKTUE], nga i ati [REDAKTUE] dhe nga nena [REDAKTUE] e gjinisë [REDAKTUE] shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, ka të kryer shkollën e mesme, mbrohet ne liri me numër personal [REDAKTUE]

#### ËSHTË FAJTOR

##### Për arsy se:

Me dt. 14.11.2017, rrëth orës 13:50 min. në rrugën "Vëllczërti Gërvalla", në drejtum të fshatit Talinovcë, duke drejtuar automjetin e markës "Opel Corsa", me ngjyrë të kaltër, me targë të regjistrimit [REDAKTUE] në kundërshtim me dispozitat e nenit 53. 1 të Ligjit mbi Sigurinë e komunikacionit rrugor të Kosovës (LSKRR), duke mos përshtatur shpejtësinë e lëvizjes kushteve në rrugë, me të arritur tek ordinance "Jeta", ka rrezikuar trafikun publik dhe jetën e njerëzve, deri sa tanë i ndjeri [REDAKTUE] ishte duke trupuar rrugën nga ana e majtë në të djathë shikuar në drejtim të lëvizjes së automjetit, me këtë rast i pandehuri me pjesën e përparme të anës së majtë të automjetit të tij e godet tanë të ndjerin ku nga goditja i njëjti hedhet mbi automjet e godet parafagon e automjetit e më pas bie në tokë, ku nga lëndimet e marrura më datën 06.12.2017 në ora 09:40 ka ndërruar jetë në repartin e neurologjisë pranë QKUK-së Prishtinë.

-me çka ka kryer vepre penale : rrezikimi i trafikut publik nga neni 378 par 9 e lidhur me par 1 dhe 6 të KPRK-së.

Gjykata konform neneve 41, 42, 43, 45, 46, 47 dhe nenit 378 par 9 e lidhur me par 1 dhe 6 të KPRK-së dhe dhe neneve 361, 362, 365, dhe 450 të KPPRK-së e

## GJ Y K O N DËNIM BURGIMI

I. Te pandehurit [REDACTED] shqipton dënim me burg ne kohëzgjatje prej 6 (gjashtë) muajve me pëlqimin e të pandehurit dënim me burg i është zëvendësuar me dënim gjobe ne lartësi prej dy mijë (2,000) Euro nga rrëthanat e arsyeshme i mundëson ta paguan me këste për një periudhë prej një viti, konform nenit 46 par.2 të KPRK-së, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

II. Përfaqësuesi i të ndjerit [REDACTED] nga Ferizaj rr. [REDACTED] nr. [REDACTED] për realizimin e kërkesës pasurore-juridike është udhëzuar në kontest civil.

III. Obligohet i akuzuari të paguaj shpenzimet e procedurës penale për ekspertizën mjeko-ligjore shumën prej 20 Euro, për ekspertizën e ekspertit të komunikacionit në shumë prej 40,88 Euro si dhe paushallin gjyqësor në shumë prej nga 20 (njëzetë) Euro, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarimit të dhunshëm.

IV. Obligohet i akuzuari të paguaj taksën në shumën prej 30 Euro, konform nenit 39 paragrafi 3 nën paragrafi 3.1 të Ligjit për Kompenzimin e Viktimave të Krimít.

Gjykata propozimin për shqiptimin e dënitit plotësues që të ia ndaloj drejtimin e automjetit të pandehurit nuk ia ka shqiptuar.

### A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Ferizaj, Departamenti i Përgjithshme ka ngritur aktakuzë PP/II.nr.2476-4/2017 të datës 14.12.2017, kundër të pandehurit [REDACTED] nga fshati [REDACTED], Komuna Ferizaj, për shkak te veprës penale: Rrezikimi i trafikut publik nga neni 378 par 9 lidhur me par 1 dhe 6 te KPRK- së.

Gjykata duke vepruar rrëth kësaj çështje penale konform nenit 245 par.1 të KPPRK-së me dt. 15.03.2018, ka mbajtur shqyrtimin fillestare në të cilin kanë marrë pjesë prokurori i shtetit Bahri Hyseni, përfaqësuesi i të ndjerit [REDACTED], i akuzuari [REDACTED] dhe mbrojtësit i tij av. [REDACTED] nga Ferizaj.

Në fillim të shqyrtimit fillestare i akuzuari është udhëzuar në kuptim të nenit 246.1 të KPPRK-së pastaj gjyqtari gjykues ka çmuar se të drejtat e të akuzuarit janë respektuar, e më pas prokurori i shtetit ka lexuar aktakuzën të akuzuarit dhe pasi që gjyqtari është bindur se i njëjtë e ka kuptuar në tërësi aktakuzën me të cilën është akuzuar, të njëjtë i ka dhënë mundësi të deklarohet mbi fajësinë apo pafajësinë e tij lidhur me veprën penale për të cilën akuzohet.

I akuzuari [REDACTED] në shqyrtimin fillestar pranon fajësinë për veprën penale që akuzohet, bazuar në dispozitivit te aktakuzës ku në vazhdim ka theksuar se atë ditë ka qenë duke lëvizur me automjetin e tij, ku koha ishte me shi rrugë e lagur dhe papritmas tani i ndjeri ka filluar ta trupoj rrugën nga ana e majtë në të djathtë dhe e ka vërejtur të njëjtin pasi i është ofruar 7-8 metra, nga se në anën tjeter ka kaluar një automjet dhe për shkak të tij nuk ka mundur ta vërej këmbësorin më herët, dhe pasi që tani më i ndjeri ka filluar ta trupoj rrugën me një shpejtësi mjaft të madhe dhe e ka goditur ku fillimi ishte hedhur mbi automjet e pastaj është përplas në rrugë. Menjëherë është ndalur për ti dhënë ndihmë dhe ka njoftuar policinë për rastin, dhe në vazhdim është kujdes për gjendjen e tij shëndetësore deri sa ai ishte gjallë. Posa u njoftua prindi i tij, menjëherë ka shkuar tek familja e tij, ku më pas kanë arritur pajtim familjarë, ku i njëjti ka shprehur keqardhje për rastin i cili i ka ndodhë ku edhe në shqyrtimin fillestar [REDACTED], është mbajtës i familjes, ka gjendje jo të mire ekonomike i ka propozuar gjykatës që me rastin e shqiptimit të dënimit të mere për bazë si rrethana lehtësuese theksime e cekura më lartë.

Mbrojtësi i tij av. [REDACTED] në shqyrtimin fillestar e mbështet pranimin e fajësisë që e pohoj i mbrojturi i tij, i cili pranim është bërë me vullnet nga ana e tij, duke u penduar thellësisht për veprën për të cilën e ka kryer dhe është i gatshëm të pranoj çdo verdikt të Gjykatës, është vetëdijshëm për pasojat, dhe i propozon gjykatës që këtë fazë të procedurës të bëj[ pranimin e fajësisë dhe me rastin e caktimit të dënimit, prokuroria gjatë procedurës së hetimeve ka konstatuar se rrethanat që i referohen ngjarjes janë të natyrës lehtësuese, si ato objektive dhe personalitetit të të pandehurit dhe kundër tij deri tani nuk është zhvilluar asnjë procedurë penale. Gjithashtu rrethanat deri të cilat erdhë deri tek kryerja e veprës penale, edhe pse klienti i tij mori të gjitha veprimet e mundshme për të evituar kontaktin me tani të ndjerin si dhe interesimin e tij menjëherë në vend të ngjarjes për ti ofruar ndihmë të mundshme të lënduarit dhe për rastin në fjalë për gjykatën ka bazë të arsyeshme që për shqiptimin e dënimit të aplikoj dispozitat e nenit 75 par .1 dhe 1.3 të KPRK-së, ashtu që në rastin konkret të zbus vendimin mbi dënimin me të cilin do të arrihet qëllimi i paraparë me ligj. Në qoftë se Gjykata e zbut dënimin deri në gjashtë muaj me burg efektiv, pas shpalljes ës tij i mbrojturi i tij pajtohet konform nenit 47 të KPRK-së, që ti zëvendësohet me dënim me të holla.

Gjyqtari në kuptim nenit 248 par.1 nën.par.1.1, 1.2, 1.3, 1.4 dhe par.4 të KPPK-së, është e bindur se i akuzuari e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajësisë, pranimin e ka bërë vullnetarisht duke e mbështetur në provat që përmban aktakuza dhe në materialet e prezantuar nga ana e prokurorit të shtetit.

Pas pranimit të fajësisë nga ana e të akuzuarit gjyqtari në kuptim të nenit 248 par.2 të KPPK-së ka kërkuar edhe mendimin e prokurorit të shtetit lidhur me pranimin e fajësisë, mbrojtësit dhe të dëmtuarit.

Prokurri i shtetit Bahri Hyseni ka dekluaruar se pajtohet me pranimin e fajësisë në këtë fazë të procedurës nga ana e të pandehurit me që pranimin e ka mbështetur në provat që gjinden në shkresat e kësaj lënde, ashtu që me rastin e shqiptimit të dënimit Gjykata të merr parasysh pendimi për veprën e kryer si dhe raportet e mira me familjen e të ndjerit.

Përsaqësuesi i të ndjerit [REDACTED] në shqyrtimin filletar ka dekluaruar se nuk i bashkëngjetet ndjekjes penale dhe pajtohet me pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit në këtë fazë, dhe i ka propozuar Gjykatës që ndaj të pandehurit ti shqiptoj një dënim sa më të butë, pasi që nga ky aksident edhe vetë i pandehuri ndjen keqardhje dhe tani me familjen e tij kemi arritur edhe pajtim. Mirëpo i njëjti imbetet pranë kërkesës pasurore-juridike.

Në shqyrtimin filletar dhe publik gjyqtari i vetëm gjyques pas dëgjimit te palëve, ka marre aktvendim me te cilin e ka pranuar pranimin e fajësisë, nga se ka konstatuar se janë plotësuar te gjitha kushtet ligjore për një gjë të tillë. Në këtë aspekt gjyqtari i vetëm gjyques ka konstatuar se i pandehuri e ka kupuar natyrën dhe pasojat e pranimit te fajësisë, se pranimi i fajësisë është bërë vullnetarisht nga i pandehuri, se pranimi i fajësisë mbështet ne faktet e çështjes që përmban aktakuza dhe aktakuza, nuk përmban asnjë shkelje te qarta ligjor ose gabime faktike, e në veqanti pranimin e ka mbështetur në ekspertizën e ekspertit të komunikacionit e datës 12.02.2017, raporti-fletëlëshimi i datës 14.11.2017 i lëshuar në emër të tani të ndjerit [REDACTED], fletëlëshimi me numër amëz 1793 i datës 06.12.2017 si dhe shiqimi të fotove dhe i CD me inqizimin e të cilave shifet momenti i shkaktimit të aksidentit, i cili gjendet në shkresat e lëndës.

Pas deklarimit të pandehurit për pranimin e fajësisë, si dhe mbrojtësit të tij me autorizim av. [REDACTED], është mare edhe mendimi i Prokurorit te shtetit i cili është pajtuar me pranimin e fajësisë nga ana e te pandehurit, nga se pranimi i fajësisë është bërë ne mënyrë vullnetare dhe ka mbështetje ne provat te cilat janë bashkangjitur aktakuzës dhe të cilat gjinden ne shkresat e lëndës, si edhe me palët kanë dekluaruar se janë pajtuar me familjen e të ndjerit dhe ky pranim i fajësisë te merret si rrethana veçanërisht lehtësuese.

*Vlerësuar nga aspekti juridik gjykata gjeti se në veprimet e të akuzuarit manifestohen të gjiths elementet e veprës penale rrezikim i trafikut publik nga neni 378 par.6 lidhur me par. 1 të KPRK-së.*

Duke u bazuar ne neni 73 dhe 74 dhe 75 te KPRK-së me rastin e shqiptimit të dënimit ndaj të pandehurit gjykata ka mare për bazë të gjitha rrethanat që ndikojnë ne llojin dhe lartësinë e dënimit. Ne veçanti me rastin e shqiptimit te dënimit është mare për bazë faktin se i pandehuri dhe familjaret e të dëmtuarës janë pajtuar, bashkëpunim i vazhdueshme i te pandehurit me organet e drejtësisë, se i pandehuri qe nga momentin kur ka ndodhur rasti –ngjarja nuk e ka vënë ne dilemë ngjarjen e ndodhur por gjithnjë ka shpreh keqardhje për atë çka ka ndodhe, sjelljen korekte te pandehurit gjatë shqyrtimit filletar, është ndier i përgjegjshëm për veprimet e tije, dhe ka shprehe keqardhje për veprën që e ka kryer, është penduar për kryerjen e kësaj veprë

penale se me pare nuk ka qene i dënuar për asnjë vepër tjetër penale, si dhe premtimi i tij se ne te ardhmen nuk do te kryej ndonjë vepër tjetër penale, ndërsa gjykata nuk ka gjetur rrrethana të tjera rënduese ndaj te pandehurit. Sipas bindjes se gjykatës dënim i shqiptuar si në dispozitiv të aktgjykimit për të pandehurin [REDACTED] duke marrë për baze rrrethana e përmendura me lart, është dënim i drejt e ne harmoni me peshën e veprës penale dhe shkallen e përgjegjësisë se te pandehurit, si dhe me intesitetin e rrezikimit te vlera te mbrojtura te shoqërisë, dhe për këtë duke u bazuar në nenin 75 par. I nën par. 1.2 ka konstatuar se ekzistojnë rrrethana posaçërsisht lehtësuese të cilat tregojnë se dënim i shqiptuar kundër të pandehurit mund të arrihet edhe me shqiptimin e dënimit më të butë, Gjykata gjithashtu është e bindur se vendimi mbi dënim do të shërbej për arritjen e qëllimit të dënimit në pengimin e të pandehurit ne kryerjen e veprave penale ne te ardhmen, do të ndikoj edhe si preventive e përgjithshme për personat e tjerë që të përbahen nga kryerja e veprave penale në përputhje me nenin 41 te PPK-së.

Te pandehurit konform nenit 47 të KPPK-së e me pëlqimin e tij dënim i shqiptuar me burg ne kohëzgjatje prej 6 muajve i është zëvendësuar me dënim gjobë.

Gjykata me rastin e shqiptimit të sanksionit penale e shqyrtoj edhe propozimin e prokurorit të shtetit të kërkuar në aktakuzë që kundër të pandehurit [REDACTED], konfrom nenit 62 pika 2.5 dhe 67 të KPPRK-së, që ti shqiptoj dënim plotësues, të ia ndaloj drejtimin e automjetit për një kohë ashtu siq parashihet me ligj, mirëpo refuzoj propozimin e prokurorisë dhe atë duke u në faktin se të pandehurit një shqiptim i një mase të tillë do të ndikonte negativisht në plotësimin e nevojave të domosdoshme familjare, pasi që i njëjti është mbajtës kryesor i familjes dhe ndalimi për ta drejtuar automjetin për të njëtin paraqet vështirësi esenciale në aktivitet e tija jetësore.


Gjykata konformë nenit 463 parag.1 lidhur me par 3.të KPPK-së përfaqësuesin e tanit të ndjerit [REDACTED] nga Ferizaj rr. [REDACTED] nr. [REDACTED] për realizimin e kërkesës pasuroro-juridike janë udhëzuar në kontest civil.

Vendimi mbi kompensimin e shpenzimeve të procedurës penale dhe paushallit gjyqësor është sjell në bazë të nenit 450 par.2 nënpar.2.6 lidhur me nenin 453 par.1 të KPPK-së dhe nenit 39 parag.1 nën par. 3.1 të Ligjit për Kompenzimin e Viktmave të Krimtit Nr.05/L-036.

Nga arsyet e lartë përmendura është vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ**  
Departamenti i përgjithshëm-divizioni penal,  
P.nr.3171/17 me datë 15.03.2018

Zyrtari Ligjor  
Blend Rexhepi

Gjyqtari  
Adem Shaban  


**KËSHILLA JURIDIKE:** Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, përmes kësaj gjykate.